# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-439444**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama reagon sërish për pagat e magjistratëve: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri, KLP e KLG j të merrnin një vendim arbitrar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/rama-reagon-serish-per-pagat-e-magjistrateve-pavaresia-ka-rreshqitur-ne-i585763` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 09:36:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 09:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a93f8355582db3b938a8c2a8921bc2858f1ceb6f0f28ca18286ddfe29f77276d` |
| TEKSTI | `4053272dcd6985e6cadb865c0ccdf0bc63805864ce859c91b15d4d56d34a12bb` |
| PAMJA | `3d25b954cdc1f65ecb81aa5f98584a49f6d912d608c7d2d9868bb487d374ea77` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `218fdc6332bb019ebaa8589f0a92f8ce91e2a86e9bc10b783c8469f7fa42e6c4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/218fdc6332bb019ebaa8589f0a92f8ce91e2a86e9bc10b783c8469f7fa42e6c4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Rama reagon sërish për pagat e magjistratëve: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri, KLP e KLGj të merrnin një vendim arbitrar

13 Shtator 2026, 11:50Politika TEMA

Rama reagon sërish për pagat e magjistratëve: Pavarësia ka

Në një reagim direkt përmes rrjeteve sociale, kryeministri Rama ka folur sërish për pagat e gjyqësorit ku thotë se atmosfera e krijuar është tepër shqetësuese. Ai thotë se pavarësia e gjyqësorit ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri. Burimi është "kuturisja" për të marrë një vendim arbitrar për pagat e gjyqësorit duke kërkuar që Thesari i Shtetit të hapë derën, tha Rama.

"Dy shëmbëlltyrat e anës së errët të medaljes së reformës në drejtësi, dy trupa të mbingarkuara me njerëz, paga, shpenzime, por me një produktivitet që lë shumë për të dëshiruar në aspektin e misionit që kanë si trupa qeverisëse të sistemit të drejtësisë që është i pavarur, jo më në letër, por në realitetin faktik të Shqipërisë ku pavarësia aq sa ka sjellë të mira, aq edhe ka sjellë sfidën e madhe të rrëshqitjes në papërgjegjshmëri, por nuk dua të hyj në këtë temë. Është temë komplekse, është e duhura, koha në dispozicion për të transformuar rrënjësisht dhe ngritur një sistem drejtësie, ka qenë e shkurtër sepse këto janë ndryshime epokale dhe ky ndryshim epokal ka nisur.

Dua të them vetëm sesa shqetësuese, sa e shëmtuar, sa vulgare është atmosfera e krijuar nga një konflikt pushtetesh dhe nga një barrikadim i atij pushteti të pavarur, kushtetues që duhet të garantojë barazinë para ligjit për të gjithë e mbi të gjitha mbi vetveten, e mbi të gjitha përtej gërmës së ligjit të garantojë një shembull. Kur vjen puna që del nga salla e gjyqit dhe është i organizuar në shoqata për t'i dhënë zë shqetësimeve të trupës në publik. Këtu flasim për një tjetër dimension dhe është i rëndësishëm për shembullin që jepet. Janë një palë që kanë këtë interes.

Dua ta nis aty ku e fillova, te këto dy trupa këshillash, dy maja, një majë me dy trupa të piramidës së gjyqësorit. Këta burra dhe gra që paguhen jo pak dhe që janë aty për të administruar punët e gjyqësorit, jo për të bërë drejtësi, për të administruar proceset që deri dje i administronte kuvendi, politika dhe tani janë në pavarësinë e tyre të plotë. Si mundet që gjëja e parë që bëmë u kuturisëm të marrim një vendim në mes të verës dhe të nxjerrim një urdhër që është zanafilla e këtij konflikti, pagat janë këto dhe Thesari i Shtetit të hapë derën. Le të themi se kanë të drejtë, por le të themi, kjo është mënyra, rruga, shembulli, këtë ju mësojmë ne, të tërë së bashku, njerëzit e drejtësisë, qytetarëve shqiptarë? Kështu kërkohet e drejta? Në mënyrë të njëanshme? Pa ezauruar asnjë nga hapat e tjerë? ne jemi përfaqësues apo 3 shtete në konflikt? Çfarë është Shqipëria? Çfarë janë këto pushtete? Çfarë ndodh këtu? Si është e mundur që nuk hidhet hapi i parë normal? Kërkohet një kontakt, ulet njeriu në tavolinë, njerëzit që jetojnë me përgjegjësinë e një shteti", shprehet kryeministri.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama: Shqipëria drejt marrëveshjes me një rrjet të madh universitar në Londër, në plan hapja e 4 universiteteve të reja]

10:40 Politika / 5 komente

[Rezultatet e PISA 2025, Rama: Shqipëria e nisi nga fundi, sot është e para në matematikë]

10:20 Politika / 2 komente

[Ngërçi me pagat e magjistratëve, Rama publikon tabelën: Gjyqtarët shqiptarë marrin 500 euro më shumë se kolegët në Greqi, kërkojnë edhe 2000 të tjera]

09:50 Politika / 24 komente

[Kosovë/ Vazhdon sot seanca konstituive, pritet zgjedhja e nënkryetarëve dhe zhbllokimi i institucioneve]

08:52 Politika

[Diskutimet për bashkimin e Vlorës me Selenicën, Rama reagon pas bashkëbisedimit me qytetarët]

22:20 Politika / 14 komente

[Protesta përçahet sërish, një grup nis "mosbindjen civile" dhe bllokon Unazën e Vogël]

21:57 Politika / 16 komente

[Balla nga Prishtina: Më 16 shtator drejtësia duhet të shpallë të pafajshëm udhëheqësit e UÇK-së]

21:30 Politika / 4 komente

["A do takohesh në Tiranë me ambasadorin amerikan", Berisha ngec: A jam unë amerikan apo shqiptar?!]

19:30 Politika / 17 komente

["Njësitë administrative nuk funksionojnë si duhet", Rama në Gjirokastër për Reformën Territoriale: Çdo qytet do ketë drejtuesin e tij]

19:00 Politika / 5 komente

["S'ishim për të marrë vendim", Çuçi për takimin në Vlorë: Njerëzit nuk e kuptojnë thelbin e Reformës Territoriale, mbledhja shumë e domosdoshme]

18:40 Politika / 13 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**[Unë jam me Petrit Malajn]**

14:45 Blog / 59 komente

**‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...**

15:15 Rajoni / 66 komente

**BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...**

14:30 Rajoni / 31 komente

**John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?**

11:40 Blog / 20 komente

**VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...**

10:02 Politika / 7 komente

## Blog Tema

**EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"**

10:30 Blog / 1 koment

**Demokracia jonë pa hardware dhe software?!**

08:23 Blog / 6 komente

**Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike**

18:43 Blog

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.